



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

Legjislatura VI  
*Sesioni vjeshtor*

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.38/2018

Prishtinë, më 4 dhjetor 2018

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Shemsi Syla, Fisnik Ismaili, Teuta Haxhiu dhe Veton Berisha.

Munguan: Sasha Milosavljeviq, Mirjeta Kalludra dhe Saranda Bogujevci,

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator.

Pjesëmarrës të tjerë: Naim Qelaj- Ministria e Drejtësisë, Edi Gusia-ABGJ, Adelina Kajtazi-ABGJ, Edona Hajrullahu-IAP, Merita Syla - IAP, Rozafa Kelmendi - UN-Women, Donika Bekteshi-KDI dhe Zana Ulaj, praktikante, Kuvendi i Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e Komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e komisionit, andaj Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Diskutim lidhur me fushatën për aktivizimin kundër dhunës në baza Gjinore.  
Të ftuar: Koordinatori Nacional për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Agjencia për Barazi Gjinore, Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Shoqatat për Mbrojtjen e të Drejtave të Grave;
2. Të ndryshme.

\*\*\*

## **1. Diskutim lidhur me fushatën për aktivizimin kundër dhunës në baza Gjinore. Të**

**ftuar: Koordinator Nacional për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Agjencia për Barazi Gjinore, Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Shoqatat për Mbrojtjen e të**

### **Drejtave të Grave**

Kryetarja tha se jemi këtu për të diskutuar për fushatën kundër dhunës në familje dhe për të parë se si është situata në terren, e dimë se nuk është ashtu si ne dëshirojmë, por bashkërisht do mundohemi të bëjmë më shumë për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve brenda familjes.

Naim Qela, koordinator Nacional për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, tha se kur e kam pranuar këtë detyrë i kam parashtruar vetës tri prioritete të cilat kanë qenë: hartimi i platformës së grupit ndërinstitucional me qëllim të raportimit të rregullt dhe periodik, caktimi i kriterëve për llogaridhënie dhe gjetjen e mekanizmave për matjen e rezultateve për zbatimin e strategjisë.

E dyta ka qenë krijimi i një baze të vetme të dhënave për rastet e dhunës në familje nga do të dilnin të gjitha raportet dhe analizat për nevojat e institucioneve si mundësi e ndërhyrjes për ta luftuar këtë dukuri të rëndë shoqërore dhe prioriteti i tretë ka qenë koordinimi më i mirë ndërinstitucional mes anëtareve të grupit ministror që është i caktuar për zbatimin e Strategjisë Kombëtare Kundër Dhunës në Familje, krijimin e një kalendari të përbashkët të aktiviteteve dhe krijimin e mekanizmave komunal për zbatimin e strategjisë dhe të gjitha këto objektiva janë të realizuara.

Së bashku me Agjencinë për Barazi Gjinore dhe me deputeten Mexhide Mjaku-Topallin, në cilësinë e kryetares së grupit të grave deputete, kemi arritur që për një periudhë të shkurtër kohore t'i vizitojmë shtatë prokuroritë dhe gjykatat themelore në vend.

Nga ajo që kemi parë gjatë këtyre takimeve kemi arritur me nxjerrë një dokument të cilin ia kemi dorëzuar Këshillit Prokurorial të Kosovës, Këshillit Gjyqësor, Kryetarëve të Gjykatave dhe Kryeprokurorëve. Ky dokument përmban edhe të gjeturat që ne e kemi hasur në terren si dhe sugjerimet lidhur me veprimet që këto institucione duhet me i ndërmarrë me përmirësuar afrimin e shërbimeve për rastet e dhunës në familje.

Nga këto takime kemi vërejtur se të gjitha prokuroritë kanë caktuar koordinatorë nga radhët e prokurorëve të cilët në mënyrë të veçantë kanë me u marr vetëm me rastet e dhunës në familje, ndërsa nuk janë caktuar gjyqtarët, por janë në proces dhe shume shpjet kanë me qenë edhe këta që i trajtojnë këto raste.

Është konstatuar se ka nevojë për ndryshimin dhe harmonizimin e ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje me kodin penal dhe ligjin për kompensimin e viktimave, mund të konstatojë se me një punë të mirë në vazhdim mund t'i plotësojmë kriteret që i ka përcaktuar Konventa e Stambollit. Ai tha se të njëjtën punë e ka bërë edhe me Policinë, ka vizituar shtatë rajonet e policisë, dhe tha se shteti duhet me ndërhyrë në polici, sidomos në tri segmente, si, krijimi i kushteve më të mira në disa rajone, akoma nuk është krijuar një drejtori e veçantë që merret me rastet e dhunës në familje, po ashtu kanë mungesë në një fond minimal për hetuesit e dhunës në familje kur duhet me i plotësuar nevojat elementare të viktimave të dhunës në familje.

Ai tha se problem është edhe me buxhetin e qëndrueshëm për financimin e strehimoreve për viktimat, se është aprovuar nga Ministria e Pushtetit Lokal koncept- dokumenti për ndryshimin

e Ligjit për Financimin e Pushtetit Lokal, po ashtu është aprovuar nga Ministria e Financave, ku parashihet të jetë një grand specifik për programe sociale.

Edona Hajrullahu tha se procesi fillon prej parandalimit e deri te ri integrimi dhe të gjitha këto etapa kanë sfida dhe probleme dhe pa qenë i koordinuar krejt procesi është e pamundur me pasur ndikim pozitiv, është punë e mirë që po bëhet me data bazën sepse aty do të vlerësohet komplet sistemi. Qendrat për punë sociale nuk kanë ide se cilat familje kanë nevoja sociale dhe ekonomike, ato duhet me i pasur të identifikuar me i vizituar ato, me i parë nevojat që i kanë. Ajo tha se kemi fillua me një hetim ex officio duke u nisur edhe nga rasti i fundit që ka ndodhur në Gjakovë për të parë konkretisht zbatimin e ligjit për mbikëqyrjen elektronike, sepse nëse do të kishte pasur zbatim ky ligj ajo viktimë do të ishte gjallë, ky ligj nuk gjen zbatim që nga hyrja në fuqi në vitin 2015, në mungesë të buxhetit.

Edi Guçia tha se unanimisht pajtohemi se dënimet janë minimale, një prej problemeve shumë të rëndësishme është qasja e komunave ndaj strehimoreve. Komunitat kanë përgjegjësi me ligjin për vetëqeverisje lokale me ndarë mjete financiare për strehimoret, të cilat e mbulojnë rajonin e tyre. Komuna e Prishtinës e ka një strehimore aty edhe tetë komuna të tjera i dërgojnë rastet e veta, kjo strehimore është ballafaquar me 47 raste, ajo tha se përveç mungesës së resurseve financiare ballafaqohen edhe me mungesë të resurseve humane. Tha se kemi vazhduar me 16 ditë të aktivizimit, e kemi ndriçuar ndërtesën e qeverisë me ngjyrën portokalli dhe kanë dalë emrat e të gjitha grave viktimat të dhunës në familje. Gjithashtu u jemi adresuar me shkresë të gjitha ministrive dhe komunave që së paku simbolin e kordeles së bardhë që simbolizon 16 ditë të aktivizimit ta vendosin, kemi botuar materiale promovuese me numrat kontaktues të të gjithë atyre që afrojnë shërbime për viktimat e dhunës në familje.

Ajo tha se është e rëndësishme ta kemi një strehimore për burrat në kuptimin që jo të strehohen vetëm ata që janë viktimat potenciale të dhunës në familje, sepse ne po flasim për gratë, por edhe burrat e moshuar dhe gratë e moshuara shumë shpesh janë viktimat të dhunës në familje e edhe të dhunës në baza gjinore. Po ashtu edhe një strehimore në nivel të vendit në veri është dashur të funksionojë nën ombrellën e Republikës së Kosovës.

Rozafa Kelmendi, UN Woman, tha se te strehimoret problem është financimi i strehimoreve. Ajo tregoi për bashkëpunimin që kanë me Grupin e Grave Deputete dhe me Koordinatorin Nacional për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, si dhe nismën që e kanë ndërmarrë për ndryshimin e ligjit për familjen.

Teuta Haxhiu, tha se kur kemi bërë monitorime të ligjeve, ashtu siç jemi tani jemi duke e bërë monitorimin e ligjit për barazi gjinore, nga vizitat që kemi pasur nëpër komuna kemi parë se zyrtaret për barazi gjinore nuk janë edhe aq në nivel, por jo për shkak të fajit të tyre, po për shkak të trajtimit që u bëhet. Nuk zbatohet saktë përkrahimin i detyrave të punës së tyre, ata obligohen të kryejnë edhe punë të fushave administrative të tjera. Ajo tha se po shihet se është bërë punë e mirë, por duhet të vazhdohet e të punohet edhe më shumë dhe të informohemi me punën që po bëhet. U tha se dënimet janë shumë të vogla, atëherë çka mundemi me bërë ne si anëtarë në kuadër të fushëveprimit të Komisionit Funkcional.

Mexhide Mjaku-Topalli tha se nga rezoluta e miratuar më 8 mars të vitit të kaluar në seancë plenare për secilën pikë të rezolutës do ta kemi nga një përgjigjeje. Tha se sa i përket rekomandimit të tretë për ri integrimin e viktimave të dhunës në familje është përmend nga koordinatori se ka ngecje, atëherë çka do të bëhet në këtë drejtim. Nëse nuk mund të na

përgjigjeni sot, mundeni të na i dërgoni përgjigjet me shkrim. Ajo më tutje pyeti se çka do të bëhet me përfshirjen e programeve për riaftësimin profesional të grave dhe integrimin në tregun e punës. Kemi parë gjithashtu se strehimoret nuk janë zgjidhje për gratë, kemi parë se komuna e Gjilanit ka bërë një banim social dhe është një model i mirë edhe për komunat e tjera.

Fisnik Ismaili u tha se janë 1200 raste të lajmëruara se kanë paralajmëruar për dhunë në familje, dhe në bazë të një dokumentari që është shfaqur ka dalë se vetëm 10%, e rasteve lajmërohen që do të thotë se numri është më i madh i atyre që kanë përjetuar dhunë. Ai pyeti pse nuk po mundemi me gjetur një vend ku ka matje për të parë se prej vitit të kaluar a ka pasur përmirësim apo përkeqësim dhe tha se atë çka po e lexoj për policinë nuk jam duke i besuar, sepse viktima e dhunës në familje Valbona Marku-Ndrecaj, ka humbur jetën pikërisht për mosveprim. Çka jemi duke bërë për me i vetëdijesuar këto gra dhe ato të kuptojnë më lehtë se si të kenë qasje për të raportuar një rast.

Edi Guçia tha se është një statistikë në Kosovë, ku 68%, e grave ndonjëherë në jetë kanë përjetuar dhunë fizike, por nëse kemi mbërritur 1200 raste në vit me u lajmëruar, atëherë ka një ngritje të vetëdijes së besimit ndaj institucioneve për me e lajmëruar rastin, dhe tha se të dhënat i posedon policia e Kosovës.

Fisnik Ismaili tha se po i shoh dy çështje që e zgjidhin këtë problem, është mekanizmi dhe është fushata e vetëdijesimit që tregon për mekanizmin, ne kemi problem me mekanizmin. Tha se rritja e dënimeve dhe fushata do ketë sukses dhe kjo fushatë do të kishte funksionuar.

Shemsi Sylja tha se e përcjelli fjalimin e koordinatorit me kujdes dhe e përgëzon për punën që e ka bërë. U theksua se ka filluar të bëjë data bazën dhe kanë filluar shumë punë të mira, por është shqetësuese se çka ka ndodhur 20 vite përpara. Po ashtu ai bëri një pyetje për IAP se a kanë vizituar ndonjëherë Qendrën për Kujdesin e Grave në Prishtinë, e dini se qe tri vite ato që punojnë aty nuk marrin pagë, dhe tani ka filluar me nga 120 euro. Ajo qendër është degraduar dhe tani është afër për t'u mbyllur.

Edi Guçia tha se për atë qendër nuk ka pasur barna nga lista esenciale, i është drejtua sekretarit të përhershëm të Ministrisë së Shëndetësisë dhe brenda tri dite Ministria e Shëndetësisë ju ka afruar barna nga lista esenciale në vlerë prej 1600 euro.

Vitin e kaluar, kur është ngritur çështja se strehimoret po mbyllen, e kam adresuar atë çështje te kabineti, është reaguuar dhe ju ka ndarë 35000 euro, mirëpo, ajo nuk është zgjidhje e qëndrueshme pikërisht për këtë, duhet që komunat të marrin përgjegjësi tash, që nga buxheti i vet i vitit 2019 me ju ndarë strehimores së Prishtinës së paku 1500 euro në vit. Ajo strehimore prapë deri në qershor ka me pasur probleme financiare sepse rregullorja e Ministrisë së Punës i financon me projekte, sikur të ishin organizata joqeveritare.

Luljeta Veselaj-Gutaj tha se sa i përket çështjes së financimit të qëndrueshëm për strehimoret, në vitin 2015, në rekomandimet e monitorimit të ligjit për trafikimin e qenieve njerëzore ka dalë një rekomandim për krijimin e një linje të veçantë buxhetore për strehimoret, dhe kjo ka ndodhur.

Ajo më pas foli lidhur me sensibilizimin e konceptit të luftimit të dhunës në familje përmes hapësirës që mund t'i jepet në tekstet shkollore. Ajo pyeti, nëse IAP, Zyra e Koordinatorit apo ABGJ kanë dhënë ndonjë rekomandim lidhur me këtë çështje.

Lirije Kajtazi tha se a keni mundur me vërejtur se kërkesa që ta gëzojnë të drejtën pronësore gratë, ka mundur me shkaktuar apo eventualisht ka ndikuar në rritjen e dhunës në familje. A keni parë dallime eventuale, se si dënohet burri që ka shkaktuar dhunë, për dallim prej një gruaje që ka marrë guximin me shkaktuar një gjendje të tillë, dhe si është puna me vonimin e trajtimit të lëndëve së bashku me masën e dënimit në përgjithësi.

Naim Qelaj tha se për dy dekada është bërë një punë e mirë e kam gjetur një infrastrukturë të mirë, tha se për 10 muaj ka së paku 300 vizita dhe takime në terren, tha se është i njoftuar me problemet që i kanë strehimoret. MPMS-së, i është adresuar me një shkresë dhe ka dhënë të gjitha opsionet e mundshme se si mundet me u zgjedhur çështja e financimit të qëndrueshëm të strehimoreve. Përveç atyre 24000 euro që i marrin secila strehimore në vit nga MPMS është

afruar gatishmëria me i financuar edhe %, por kjo nuk ka qenë e mundur për shkak të praktikave dhe se është në kundërshtim me praktikat ndërkombëtare. Në fakt nuk është lejuar që këto institucione të jenë shtetërore është ruajtur autonomia e tyre si Organizata Joqeveritare. Sa i përket lartësisë së dënimeve tha se nuk janë në nivelin e duhur.

Kryetarja u tha se kemi prokuror për rastet e dhunës në familje, atëherë sa janë profesionist dhe sa lëndë kanë pasur për një vit.

Naim Qela tha se rastet trajtohen sipas ligjit, asnjë rast që shkon me urdhër mbrojtës nuk kalon 24 orë pa u dorëzuar në gjykatë dhe pa u trajtuar prej gjykatës, këtë e them me përgjegjësi. Ngecje ka te trajtimi i rasteve penale, te kërkesa për urdhër mbrojtës të jeni të sigurt se nuk ka ngecje dhe kjo është rezultat edhe i punës promovuese që është bërë. Sa i përket raporteve të institucioneve është raporti monitorues për zbatimin e strategjisë, atë raport e kemi zberthyer në atë formë që secili institucion që ka së paku një aktivitet për dhunën në familje për atë. Akademia e Drejtësisë ka mbajtur disa trajnime me gjyqtarë dhe prokurorë pikërisht sa i përket barazisë gjinore dhe temës së dhunës në familje, roli i mekanizmave komunal shkon në favor të mbrojtjes e sidomos të ri integritet të viktimave të dhunës në familje, obligimi i komunës është me krijuar programe përveç atyre që i kanë për me e fuqizuar rolin e viktimës ekonomikisht. Kemi kërkuar nga kryetarët e komunave që kur të bëjnë ndarjen e banesave për rastet sociale, përherë nga ato banesa që ndajnë dy sosh të ndahen për rastet e viktimave të dhunës në familje.

Edi Guçia tha se lidhur me çështjen e financimit të strehimoreve, me strategjinë nacionale 2016-2020, që është miratuar në qeveri, komunat e kanë obligim me ndarë buxhet për strehimoret që i strehojnë viktimat në komunën e tyre.

Naim Qelaj tha se sa i përket sistemit edukativo arsimor ka bërë kërkesë në MASHT me zbatuar prioritetet që janë të përcaktuara në strategji, me u ndryshua rregullorja për caktimin e punëtorëve profesional në shkollat nr.67/2013.

Kërkesa e femrave për të pasur pronë apo trashëgimi nuk e rrit numrin e dhunës në familje, mundet me pas raste individuale. Sa i përket vonesave në trajtim të rasteve shqetësimi më i madh mbetet trajtimi i rasteve në aspektin civil, lëndët civile sidomos në Gjykatën e Apelit.

Veton Berisha tha se a kemi statistika dhe informata pse ndodhin këto ngjarje, dhe a merret dikush me parandalim para se me ndodhur. Në komunitetin tim tha se dallojnë shkaqet e dhunës, ku bëjnë pjesë shkaqet ekonomik-socialë, mos edukimi e arsimit dhe shkaqet tjera.

Mexhide Mjaku-Topalli, lidhur me rekomandimin e vitit 2016 dhe rekomandimin e vitit 2018 të miratuara në Kuvend, është për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, parashtrori pyetje se a do ta bëni ju si propozim apo do ta iniciojmë ne, si komision, dhe ky ndryshim a ka nevojë të ndodhe apo jo?

Teuta Haxhiu, lidhur me strehimoret ku janë të strehuara gratë që kanë përjetuar dhunë në familje, tha se ato objekte janë shumë shqetësuese. Pastaj ka keqpërdorime në punësime të stafit, nuk ka fare siguri në ato objekte dhe parashtrori pyetjen nëse i keni vizituar si institucione ato objekte.

Naim Qela tha se shtylla e parë e strategjisë është parandalimi dhe vetëdijesimi, dhe kësaj shtylle i jepet shumë rëndësi.

Rritja e numrit të pedagogëve dhe psikologeve në shkolla, pastaj fushatat sensibilizuese, qoftë përmes mediave, qoftë takimet me qytetarët të gjitha janë në funksion të parandalimit.

Sa i përket ndryshimeve të ligjeve tha se është një vendim i Ministrisë së Drejtësisë që deri në gjysmën e dytë të vitit 2019, mos me pasur iniciativa për ndryshime ligjore për arsye se jemi në fazën e rishikimit funksional në të gjithë sistemin dhe është duke u pritur si po reflekton analiza që ka me u bërë nga rishikimi funksional për me marr iniciativa për ndryshime ligjore. Sa i përket strehimoreve tha se gjendja e tyre nuk është e mirë, janë dy tipe të strehimoreve të tipit të mbyllur dhe të tipit gjysmë i hapur. Te tipi i hapur viktimat janë aktive dhe mund të punojnë dhe të kenë aktivitete të ndryshme, me inspektimin e strehimoreve duhet të merret Inspektorati i MPMS-së, dhe kam kërkuar nga ata që të përgatisin një raport për gjendjen e këtyre strehimoreve.

Merita Syla tha se i kanë vizituar strehimoret në terren dhe se është shumë e dhimbshme jeta në strehimore edhe për fëmijët sepse ata strehohen aty me nënat e tyre dhe gjatë gjithë kohës janë në qasjen e rrëfimeve që viktimat e dhunës e kanë përjetuar, dhe ata fëmijë po i nënshtrohen edhe dhunës psikike dhe nuk ka ndonjë plan për mbrojtjen e atyre fëmijëve.

## **2. Të ndryshme**

Mexhide Mjaku-Topalli tha se është mirë që të ftohen përfaqësuesit e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, që të diskutojmë lidhur me për marrëveshjen e fundit që është nënshkruar në Hagë dhe për raportin e KDI-së lidhur me çështjen e të pagjeturve.

Lirije Kajtazi, tha se dje në Kosovë ka qëndruar Komisionari për zgjerim i BE-së, z. Han, dhe nga ai nuk morëm lajme të mira dhe u tha se datë reale për liberalizim është viti 2020, dhe ne, si Komision për të Drejtat e Njeriut, është mirë të reagojmë përmes një komunikate apo deklaratë, lidhur me këtë çështje.

Pas diskutimeve lidhur me këtë çështje, kryetarja konstatoi se anëtarët e Komisionit Funksional, vendosën që të prononcohen përmes një reagimi të tillë lidhur me mos liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

*E përgatiti:*

*Stafi mbështetës i komisionit.*

Kryetarja e komisionit,

---

Duda Balje